



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafin (1), pikën 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe nr. 74/24), nenin 124, paragrafin (7) dhe nenin 125, paragrafin (3) të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 90/22 dhe nr. 64/24), dhe lidhur me nenin 79 dhe 80 të Ligjit për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 64/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kërkesave për autentifikim të përforcuar dhe për standarde të përgjithshme, të sigurta dhe të hapura të komunikimit

1. Në Vendimin për përcaktimin e kërkesave për autentifikim të përforcuar dhe për standarde të përgjithshme, të sigurta dhe të hapura të komunikimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 12/23), pika 67) ndryshohet dhe bëhet:

“Ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilët deri më 31 dhjetor 2022 nuk kanë vendosur autentifikim të përforcuar të klientit kur paguesi nis një transaksion pagesor elektronik, janë të detyruar të vendosin atë jo më vonë se 1 tetor 2024.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, në rastin kur paguesi nis transaksion pagesor elektronik të bazuar në kartelë në pikat e shitjes nga distanca, ofruesit e shërbimeve të pagesave janë të detyruar ta vendosin autentifikimin e përforcuar të klientit, jo më vonë se 1 marsi 2026.

Ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilët nuk e kanë përshtatur funksionimin e tyre me kërkesat nga kreu IV i këtij vendimi, janë të detyruar ta përshtatin funksionimin e tyre me kërkesat nga kreu IV të këtij vendimi jo më vonë se 1 mars 2026.

Deri në harmonizimin e funksionimit të ofruesve të shërbimeve të pagesave me afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilët i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar që:

- të sigurojnë platformë teknike dhe mbështetje, për testim të lidhjes dhe funksionaliteteve të interfejsit, në pajtim me pikën 40) të këtij vendimi dhe vërtetim të harmonizimit të kërkesave ligjore lidhur me dizajnin e interfejsit të dedikuar dhe rezultateve totale nga testi, në pajtim me udhëzimet e Aneksit nr. 6 bashkangjitur me këtë vendim, së paku pesë muaj para datës së harmonizimit sipas paragrafit (3) të kësaj pike;
- të dorëzojnë raport se interfejsi i dedikuar nuk krijon pengesa gjatë sigurimit të shërbimeve të nisjes së pagesave dhe shërbimeve për ofrim të informacioneve të llogarive pagesore, së paku dy muaj para datës së përshtatjes së funksionimit të saj sipas paragrafit (3) të kësaj pike;



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- të dorëzojnë raport përmbledhës nga rezultatet e stres testimit të rezistencës, si dhe informacion për mënyrat me të cilat janë tejkaluar dobësitë e identifikuara, të paktën një muaj para datës së përshtatjes së funksionimit të saj sipas paragrafit (3) të kësaj pike.”

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V. nr. 02-23460/2024

26 Qershor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së
Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska